

# **AKT THEMELIMI DHE STATUTI I SHOQËRISË**

## **“GEGA 96” SHPK**

Ky statut do të konsiderohet se përfshin dhe Aktin e Themelimit të Shoqërisë, organizimi dhe funksionimi i të cilës rregullohet këtu:

Sot më **07 Nëntor 2023**, unë **Vlash Gega**, shtetas shqiptar, lindur më 14.12.1961 në Milot, dhe banues në adresën: Rruga “Ndoc Deda”, Ndërtesa 38, Hyrja 7, Apartamenti 2, Milot, Kurbin mbajtës i kartës së identitetit me numër personal G11214037B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, në përputhje me Ligjin Nr.9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” dhe me legjislacionin e zbatueshëm në Republikën e Shqipërisë, miratoj këtë Statut si vijon:

Në këtë Statut

- “Ligji” është Ligji 9901/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” i ndryshuar
- “Statuti” është ky Statut i Shoqërisë

### **KREU I**

**Themelimi, Emri, Objekti, Kohëzgjatja**

**Neni 1**

**Data e Themelimit, Emri i Themeluesit, Selia**

Sot me datë 07 Nëntor 2023, unë themeluesi i mësipërm kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin tregtar **“GEGA 96” shpk.**



## Neni 2

### Objekti i veprimtarisë

Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

*Veprimtari në fushën e ndërtimit, montimit dhe rikonstrukzionit të objekteve e veprave të çdo lloji, qofshin publike dhe private, studime e projekteve të ndryshme, konsultime tekniko-inxhinierike si dhe çdo lloj aktiviteti tjeter të lejuar me ligj. Punime ndërtimi dhe projektimi sipas licencës së lëshuar nga Ministria e Ndërtimit. Prodhim dhe tregtim i materialeve të ndërtimit dhe materialeve të ndryshme. Shërbim ndërmjetësimi për tregimin e materialeve të ndërtimit dhe të artikujve të ndryshëm mes kompanive në tregun shqiptar me ato në tregun e huaj dhe anasjelltas.*

## Neni 3

### Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë e pacaktuar dhe/ose e pakufizuar.

## Neni 4

### Selia

Selia e shoqërisë ndodhet në adresën: *Milot, pranë Autostradës Milot-Rrëshen, Kioskë, pranë Restorant Barcelona, ZK 2693, Pasuria Nr.I/52.*

Me vendimin e Administratorit, shoqëria mund të çelë degë dhe/ose zyra përfaqësimi brenda ose jashtë Republikës së Shqipërisë.

## KREU II

### Neni 5

### Kapilati Themeltar

Kapitali themeltar fillestar i shoqërisë është 100.000 (njëqind mijë) lekë dhe zotërohet tërësisht nga ortaku themelues



- Z. Vlash Gega zotëruesh i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme 100.000 lekë që përbën 100% të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Kontributi i ortakut është në para.

Secili ortak do të ketë një numër proporcional votash me vlerën nominale të kuotës së tij.

## Neni 6

### Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit

Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti të autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit.

Në asnjë rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.

Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga asambleja e ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit. Në të gjitha rastet zvogëlimi i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.

## Neni 7

### Transferimi i kapitalit

Kuotat e kapitalit e të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- Kontributeve në kapitalin e shoqërisë
- Shitblerjes
- Trashëgimisë
- Dhurimit
- Çdo mënyrë tjeter të parashikuar me ligj.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme nëpërmjet ortakëve, përsë nuk parashikohet ndryshe në statut.

Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme me rrugë trashëgimie.

## KREU II

### Organet vendimmarrëse dhe drejtuese

#### Neni 8

##### Organi vendimmarrës

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.

Asambleja e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj.

Asambleja e përgjithshme e ortakëve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqërinë për çështjet e mëposhtme:

- a. Përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë
- b. Ndryshimin e statutit
- c. Emërtimin e shkarkimin e administratorëve
- d. Emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe audituesit ligjorë
- e. Përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat c dhe d të kësaj pike.
- f. Mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë.
- g. Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë
- h. Zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit
- i. Pjestimin e kuotave dhe anullimin e tyre
- j. Përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve
- k. Riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë
- l. Miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë
- m. Shpérndarjen e fitimeve vjetore
- n. Çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statute.

Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër, apo nga një person i tretë.



Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëtin rend dite.

## Neni 9

### Mënyra e thirrjes së mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme

Asambleja e Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë ose, nëse parashikohet nga statute, me njoftim nëpërmjet postës elektronike. Njoftimi me shkresë, apo me mesazh elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen e asamblesë.

Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij nenit, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakort për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.

## Neni 10

### Kuorumi

Në rastin e marrjes së vendimeve që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë votë që zoterojnë më shumë se 30% të kuotave. Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se gjysmën e numrit total të votave janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo me mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.

Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuoromit të përmendor më lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë me të njëtin rend dite.



## **Neni 11**

### **Marrja e vendimeve**

Asambleja e përgjithshme vodos me  $\frac{3}{4}$  e votave të zotëruesve të kapitalit të ortakëve pjesëmarrës, për ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë. Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e votave të ortakëve pjesëmarrës, për çështje të tjera si: përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë; emërimin e administratorëve; emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve, audituesve ligjorë; përcaktimin e shpërblimeve; mbikqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët që përfshijnë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë; përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve; miratimin e rregullave proceduriale të mbledhjeve të asamblesë.

## **Neni 12**

### **Përjashtimi nga e drejta e votës**

Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme merr vendim për: vlerësimin e veprimtarisë së tij; shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij; ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria; dhënien ose jo të përfitimeve të reja. Kur ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson.

## **Neni 13**

### **Administratorët**

Asambleja e përgjithshme emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë. Afati i emëritit është 5 vjet me të drejtë ripërtëritje. Emërimi i administratorëve prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit.

Personat e mëposhtëm caktohen si administratorë të parë të shoqërisë për një mandat 5 (pesë) vjeçar emërimi:

- Z. **Vlash Gega**, shtetas shqiptar, lindur më 14.12.1961 në Milot dhe mbajtës i kartës së identitetit me numër personal G11214037B, madhor dhe me zotësi të plotë juridike për të vepruar, pa kufizime në kompetencat e administrimit.



## **KREU IV**

### **Viti finansiar-audituesit ligjorë**

#### **Neni 14**

##### **Viti finansiar**

Viti finansiar i shoqërisë fillon më 1 Janar dhe përfundon më 31 Dhjetor. Përjashtimisht, viti i parë finansiar fillon nga data e regjistrimit të shoqërisë në Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbyllt më 31 Dhjetor.

#### **Neni 15**

##### **Audituesit Ligjorë**

Audituesi Ligjor ka për detyrë që të kontrollojë të gjithë dokumentacionin kontabël të veprimtarisë ekonomike tregtare të shoqërisë, atë vjetor dhe atë në lidhje me kontrollet periodike të ushtruara prej tij për rastet kur ai është ngarkuar dhe ka kryer një gjë të tillë i ngarkuar nga ana e ortakëve. Në përfundim të kontrollit, audituesi ligjor i autorizuar përgatit raportin me shkrim për nxjerrjen e rezultatit të bilancit finansiar vjetor si dhe për kontrollet periodike të ushtruara, të cilat është i detyruar që t'ia paraqesë e t'ia dorëzojë në kohë ortakëve për t'i shqyrtuar e miratuar mbi bazën e të drejtës vendimore që ka.

## **KREU V**

### **Prishja-Riorganizimi i shoqërisë**

#### **Neni 16**

##### **Prishja dhe likuidimi**

Shpërndarja ose prishja e shoqërisë mund të bëhet në çdo kohë: kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar në themelin e saj; me vendim të asamblesë së ortakëve; me hapjen e procedurave të falimentimit; në përputhje me pikën 3 të nenit 43 të ligjit 9723/2017; me vendim të gjykatës. Në këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerrë prej tyre emrin e likuidatorit dhe emërtimin shtesë “Shoqëri në likuidim e sipër”. Prishja e shoqërisë tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.

Likuidimi kryhet nga likuiduesit që janë emëruar nga ortakët. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës për të caktuar një likuidues.

### Neni 17

#### Riorganizimi i shoqërisë, bashkimi-ndarja

Shoqëria mund të ndahet, bashkohet sipas vendimit të mbledhjes së përgjithshme të Asamblesë së Ortakëve në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën VIII të ligjit nr.9901, datë 14.04.2012 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

### Neni 18

Shoqëria do të zhvillojë aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjisacionit shqiptar. Përsa nuk parashikohet në këtë statut, do të zbatohen dispozitat e ligjit “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjeter specifik në Republikën e Shqipërisë.

### Neni 19

#### Mosmarrëveshjet

Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare.

Ky akt u hartua në gjuhën shqipe dhe pasi u lexua, u kuptua dhe u nënshkrua nga ortaku themelues si vijon:

### ORTAKU THEMELUES I

#### SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR “GEGA 96” SHPK

Vlash Gega

Vlash Gega  
Vlash Gega